

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET**
**MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS**
DHE
**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
“PËR**
NGRITJEN E NJË GRUPI TË PËRBASHKËT PUNE PËR BASHKIM DOGANOR”

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës (“MFPT”)dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikën e Shqipërisë (“MFE”) (Në vijim referuar individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”;

MEQENËSE dëshirojnë të bashkëpunojnë në analizimin, identifikimin dhe vlerësimin e kuadrit rregulator që ndikon në mundësinë e një bashkimi doganor të dy shteteve,

Bien dakord të bashkëpunojnë si më poshtë vijon:

**Neni I
Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

Qëllimi i këtij Memorandumi Bashkëpunimi është të sigurojë krijimin e një grupei të përbashkët pune, i cili në mënyrë të vazhdueshme do të punojë dhe vlerësojë faktorët të cilët ndikojnë në mundësinë e një bashkimi doganor, do të përpilojë planin për veprimet dhe procedurat dhe do të hartojë një studim kosto-përfitime për secilën palë në lidhje me këtë çështje.

**Neni II
Fushat e bashkëpunimit**

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

2.1 Krijimi i një grupei të përbashkët pune, me përfaqësues nga aparatet e shteteve respektive, detyrat funksionale e të cilëve lidhen me fushën doganore, fiskale, ligjore, zhvillimin ekonomik dhe çdo fushë tjeter që mund të ndikohet nga një bashkim doganor. Grupet e punës mund të ftojnë edhe ekspertë të jashtëm me profile të larta profesionale, të cilët do të miratohen nga Ministritë përkatëse.

2.2 Grupi i punës duhet të mbështetet nga i gjithë stafi i Ministrisë përkatëse por dhe i institucioneve të vartësisë në artikulimin e nevojave të tyre me qëllim mbledhjen e të dhënavë, analizimin e tyre dhe nxjerrjen e një produkti final në interes për të dy palët.

2.3 Nga ana operacionale, grupet e punës do të mblidhen në Ministrinë e tyre respektive ose në takime të përbashkëta, sipas formatit më të volitshëm.

2.4 Grupi i punës do të funksionojë deri në mbledhjen e ardhshme ndërqeveritare mes Kryeministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, ku do të paraqet një dokument pranë kabineteve qeveritare të Palëve.

Neni III

Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit

3.1 Palët informojnë irregullisht njëra-tjetrën dhe konsultohen për çështjet me interes të përbashkët, të cilat sipas mendimit të tyre mund të sjellin një bashkëpunim të përbashkët.

3.2 Konsultimet dhe shkëmbimi i informacionit dhe i dokumenteve në bazë të këtij Memorandumi Bashkëpunimi bëhet pa cënuar marrëveshjet, të cilat mund të jenë të nevojshme për të garantuar karakterin konfidencial dhe të kufizuar të informacionit. Këto marrëveshje mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi dhe të çdo marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet Palëve në kuadrin e këtij bashkëpunimi.

3.3 Palët, në intervale kohore që gjykohen të përshtatshme, zhvillojnë takime për të shqyrtuar ecurinë e veprimtarive që do të kryhen në bazë të këtij Memorandumi Bashkëpunimi dhe për të planifikuar veprimtaritë e ardhshme.

3.4 Palët mund të ftojnë njëra-tjetrën që të dërgojnë përfaqësues në mbledhjet e organizuara prej tyre ose nën kujdesin e tyre, kur sipas gjykimit të secilës Palë, Pala tjetër mund të ketë interes. Ftesat do të jenë objekt i procedurave të zbatueshme për këto mbledhje.

Neni IV

Zbatimi

4.1 Palët bien dakord që me hyrjen në fuqi të këtij Memorandum Bashkëpunimi, secila nga palët nënshkruese do të hartojnë dhe nënshkruajnë urdhërat/vendimet përkatës për ngritjen e grupit të punës, që do të veprojnë në emër të secilës palë, me përfaqësuesit respektiv të strukturave përgjegjëse.

4.2 Palët bien dakord për komunikimin dhe shkëmbimin e urdhërave/vendimeve të nënshkruara.

Neni V

Kohëzgjatja, Përfundimi, Rinovimi dhe Ndryshimi

5.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi do të jetë i vlefshëm deri në mbledhjen e ardhshme ndërqeveritare të Kryeministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, përvèçse kur zgjidhet më përpara nga njëra Palë, pas një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër dy muaj më përpara. Palët mund të bien dakord me shkrim që të zgjasin afatin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi për periudhat e mëvonshme.

5.2 Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshohet vetëm me anë të një marrëveshjeje të përbashkët me shkrim ndërmjet Palëve.

Neni VI

Njoftimet dhe adresat

Çdo njoftim ose kërkesë që nevojitet ose lejohet të jepet apo të bëhet në bazë të këtij Memorandumi Bashkëpunimi duhet të jetë në formë të shkruar ose në formë elektronike. Ky njoftim ose kërkesë konsiderohet se është dhënë ose është bërë në mënyrë të rregullt nëse i

dorëzohet Palës tjetër me postë elektronike dhe kur i jepet ose i dërgohet Palës përkatëse në adresën e përcaktuar më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër që mund të bëhet me dije në vijim.

Për MFPT:

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi "Nëna Terezë" 10000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Për MFE:

Delina Ibrahimaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri

**Neni VII
Të ndryshme**

7.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi përbën mirëkuptimin e plotë të Palëve lidhur me objektin e këtij Memorandumi. Mosbatimi nga njëra Palë e ndonjë dispozite të këtij Memorandumi nuk nënkupton heqjen dorë prej asaj dispozite ose nga ndonjë dispozitë tjetër e këtij Memorandumi. Pavlefshmëria ose pazbatueshmëria e ndonjë dispozite të këtij Memorandumi nuk cënon vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të tij.

7.2 Asgjë në këtë Memorandum nuk duhet të interpretohet si krijim i një sipërmarrjeje të përbashkët apo si ndonjë formë tjetër angazhimi të detyrueshëm ligjor ndërmjet Palëve.

**Neni VIII
Kostot dhe shpenzimet**

Kostot në lidhje me takimet e Grupit të Punës, të tilla si vendi dhe pajisjet e marra në dispozicion do të përballohen nga secila Palë.

**Neni VIII
Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja Palët.

NË DËSHMI TË SA MË LART, përfaqësuesit e autorizuar ligjërisht të Palëve nënshkruajnë më poshtë.

Bërë në Prishtinë, më 20 qershor 2022, në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



Delina Ibrahimaj

Ministre e Financave dhe Ekonomisë

